



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:276054

Datë: 31.10.2023

Numri i dokumentit: 04854728

APS.nr.44/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- DEPARTAMENTI SPECIALE – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Afërdita Bytyçi, kryetare e kolegjit, Bashkim Hyseni dhe Vaton Durguti anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Syzana Goxhuli, në çështjen penale kundër të akuzuarve G.M, A.M, D.D dhe H.M, për shkak se cili veç e veç ka kryer veprën penale dhënia e ryshfetit nga neni 422 par. 2 KPRK-së, si dhe se cili veç e veç ka kryer veprën penale mashtrimi me subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, ndërsa i akuzuari H.M ka kryer veprën penale dhënia e ryshfetit nga neni 422 par. 1 KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtëseve të akuzuarve G.M, av.Reshat Millaku, D.D, av.Sali Mekaj dhe H.M, av.Arbër Jashari, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore–Departamenti Special në Prishtinë, PS.nr.28/23 të datës 04.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me datë 30.10.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pa bazuara ankesat e mbrojtëseve të akuzuarve G.M, av.Reshat Millaku, D.D, av.Sali Mekaj dhe H.M, av.Arbër Jashari përkitazi me vendimin mbi dënim, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore - Departamenti Special në Prishtinë, PS.nr.28/23 të datës 04.07.2023, **VËRTETOHET**.

II.APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e të akuzuarit G.M, e paraqitur përmes avokatit av.Reshat Millaku, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.28/23 të datës 04.07.2023, ndryshohet në raport me konfiskimin dhe kompensimin e dëmit të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ashtu që kompensimi të bëhet nga mjetet e konfiskuara nga i akuzuari G.M sipas urdhëresës se PPPS.nr.47/21 të dt.02.02.2022, në lartësi prej 8.400.00 €, të përcaktuara si në aktgjykimit të ankimuar.

Arsyetimi

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.28/23 të datës 04.07.2023, të akuzuarit G.M, A.M, D.D dhe H.M, për shkak se cili veç e veç ka kryer veprën penale dhënia e ryshfetit nga neni 422 par. 2 KPRK-së, si dhe se cili veç e veç ka kryer veprën penale mashtrimi me subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, ndërsa i akuzuari H.M ka kryer veprën penale dhënia e ryshfetit nga neni 422 par. 1 KPRK-së, i ka shpallur fajtor dhe i ka gjykuar si në vijim: në pikën I të dispozitivit të akuzuarin G.M për veprën penale dhënia e ryshfetit, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1,000€ dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 9 muaj, në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe arrest shtëpiak prej datës nga data 30.06.2021 deri me datë 30.03.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Ndërsa për veprën penale mashtrim me subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, të akuzuarit G.M i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 5000€, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari G.M, nuk dëshiron ta paguajnë ose nuk mundën ta paguajnë dënim me gjobë gjykata bazuar në nenin 46 të KPK-së, dënimin me gjobë mund t ia zëvendësojë në dënim me burgim.

Ne vështrim të nenit 92 par. 1 të KRPK-së, të akuzuarit G.M, në cilësi të sendeve të përfituara me vepër penale i konfiskohen parat në vlerë 8,400.00€, të sekuestrua sipas Urdhëresës PPPS.nr.47/21, të datës 02.02.2022, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar është përgjegjëse të bëjë administrimin e pasurisë së specifikuar, në pajtim me Ligjin përkatës për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

Është obliguar i akuzuari i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind (100) €, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në pikën II të dispozitivit të akuzuarit A.M, për veprën penale dhënie ryshfeti, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1000 € dhe dënim me burg prej 6 muaj, në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës nga data 30.06.2022 deri me datë 30.07.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit A.M, dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 4000 €, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ndërsa të akuzuarit A.M, për veprën penale mashtrim me subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 5000€, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimin me gjobë i akuzuari A.M, nuk dëshiron ta paguajnë ose nuk mundën ta paguajnë gjykata bazuar në nenin 46 të KPK-së, dënimin me gjobë mund t ia zëvendësojë në dënim me burgim.

Ne vështrim të nenit 59 par 2 nën par 2.2, të KRPK-së, të akuzuari i ka caktuar dënim plotësuese. Në mbështetje të nenit 61 par 1 të KRPK-së, obligohet i pandehuri A.M që të bëjë kompensimin e dëmit të shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës- në vlerë prej 7000 €.

Është obliguar i akuzuari i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind (100) €, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në piken III të dispozitivit të akuzuarit D.D, për veprën penale dhënie ryshfeti, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1,000€ dhe dënim me burg prej 6 muaj, në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës nga data 30.06.2022 deri me datë 30.07.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit D.D, dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 4000 €, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit D.D, për veprën penale mashtrim me subvencione nga neni 324 par. 1 të KPRK-së, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 5000€, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimin me gjobë i akuzuari D.D, nuk dëshiron ta paguajnë ose nuk mundën ta paguajnë gjykata bazuar në nenin 46 të KPK-së, dënimin me gjobë mund t ia zëvendësojë në dënim me burgim.

Është obliguar i akuzuari i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind (100) €, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar nga Avokatura shtetërore për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Në pikën IV të dispozivit të akuzuarit H.M, për veprën penale dhënie ryshfeti, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1000€ dhe dënim me burg prej 6 muaj, në të cilin vendim llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës nga data 30.06.2022 deri me datë 30.07.2022, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit H.M, dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 4000 €, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Është Obliguar i akuzuari i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej dyqind (200) €, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar nga Avokatura shtetërore për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit G.M, av.Reshat Millaku, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, më propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën ashtu që aktgjykimin e ankimuar duke aplikuar dipozitat e neneve 71 dhe 72 të KPRK-së ta ndryshoj, të akuzuarit ti shqiptohet dënim unik në kohëzgjatje prej 9 muaj, duke i llogarit edhe kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej dt.30.06.2021 deri me dt.30.03.2020 ose ti shqiptoj dënim me burg nën minimumin ligjor dhe dënim me gjobë në shumë sa ma të vogël. Po ashtu mjetet e sekuestruara me urdhëresë të Gjykatës Themelore në Prishtinë të bartën në xhirollogarinë e Ministrisë së Bujqësisë, në emër të kompensimit të dëmit nga i akuzuari G.M.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.D, av.Sali Mekaj, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, më propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykim e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim me të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.M, av.Arbër Jashari, për shkak të vendimit mbi dënim, më propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykim e ankimuar ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënim ashtu që të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor ta gjykoj vetëm me dënim me gjobë, në shumë prej 1.000 euro.

Prokuroria e Apelit me parashtresën, PPA/I.nr.545/2023, datë 18.10.2023 ka propozuar që të ankesat e mbrojtëseve të akuzuarve G.M, av.Reshat Millaku, D.D, av.Sali Mekaj dhe H.M, av.Arbër Jashari të refuzohen si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPP-së, në të cilën morën pjesë i akuzuari G.M dhe mbrojtësi i tij av.Reshat Millaku, si dhe mbrojtësit e të akuzuarve D.D, av.Sali Mekaj, dhe H.M av.Arbër Jashari, kurse Prokurori i Apelit, përfaqësuesi i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të akuzuarit D.D, H.M dhe A.M, si dhe mbrojtësi i tij av.Valon Blakaj edhe pse janë njoftuar me rregull nuk morën pjesë në seancë. Mbrojtësit e të akuzuarve mbetën në tërësi pranë pretendimeve ankimore në ankesa, ndërsa i akuzuari G.M e mbështeti mbrojtësin e tij.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore në ankesa gjeti se:

Ankesat e mbrojtësve nuk janë të bazuara për vendimin mbi dënim, ndërsa ankesa e mbrojtësit G.M, av.Reshat Millaku është pjesërisht e bazuar në raport me çështjen e kompensimit.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPP-së, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, kurse aktgjykimi u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore sa i përket vendimit mbi dënim.

Pretendimet e mbrojtësve në ankesa

Në ankese mbrojtësi i të akuzuarit G.M, av.Reshat Millaku, thekson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar për të gjithë të akuzuarit, më rastin e marrjes së vendimit mbi dënim, ka marr si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë për veprat penale, pendimin e tyre, bashkëpunimin dhe sjelljen e tyre korrekte në gjykatë dhe organet e ndjekjes në fazën e hetimeve, më parë të pa gjykuar, i kanë premtuar gjykatës së në të ardhmen nuk do të bien ndesh më ligjin, për vepra të njëjta apo vepra tjera, ashtu që i'u shqiptoj dënimet si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sipas mbrojtjes gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese të cekura më lart, përveç rrethanave lehtësuese të gjetura nga gjykata, tek i akuzuari G.M ka edhe rrethana tjera lehtësuese të cilat nuk i ka marr parasysh më rastin e shqiptimit të dënimit e këto janë: kompensimi i dëmit, qysh në fazën e hetimit i akuzuari G.M, në rastin e dhënies së deklaratës së pare deri sa ka qenë në paraburgim nga prokurori i shtetit ka kërkuar që të i mundësohet shkuarja në bankë që të bëjë kompensimin e dëmit. Pas dhënies së deklaratës së dytë në prokurori, deri sa ka qenë, në arrest shtëpiak, sipas urdhrin të prokurorit të shtetit, i akuzuari G.M i shoqëruar nga hetuesit e rastit ka ardhur nga fshati R..... i P....., në P..... dhe në bankën ku pa pasur xhirollogarinë ka tërhequr00 euro, por në vend që këto të holla ti bartë nga banka në

Ministrinë e Bujqësisë, hetuesit policor me vërtetim i'a kanë sekuestruar të njëjtat, e pastaj sipas kërkesës së prokurorisë Gjykata ka lëshuar urdhëresën mbi sekuestrim PPPS.nr.47/21 të datës 02.02.2022. Ka shtuar se i akuzuari ka bërë kompensimin e dëmit e ka vërtetuar edhe prokurori i shteti në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 23.06.2023, I akuzuari G.M është i martuar, relativisht i moshës së re, baba i tre fëmijëve të mitur, bashkëshortja nuk i punon-amvise, jeton më 2 prindërit e moshuar, të sëmurë me profesion bujk. Se për dhënien e ryshfetit ka qenë i detyruar nga zyrtarët e Ministrisë së Bujqësisë edhe pse i ka plotësuar kriteret për subvencione si dhe lartësia e vogël e dëmit të shkaktuar etj.

Duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese të lartcekura rrjedhë se dënimet e shqiptuara janë shumë të ashpra dhe se në rastin konkret gjykata është dashur që të aplikoj dispozitat e nenit 71 par. 1 nën par. 3 të KPP, të bëjë zbutjen e dënimit, meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë dhe në bazë të nenit 72 të KPRK të bëjë zbutjen e dënimit, nën minimumin e paraparë ligjor.

Tutje ka shtuar se gjykata nuk ka kriter të njëjtë për të akuzuarit, të gjithë të akuzuarit tjerë për veprën penale dhënie e ryshfetit janë gjykuar nga 6 muaj burg, duke zëvendësuar më gjobë, kështu njeri nga të akuzuarit për dhënie të ryshfetit në shumë prej000 euro, gjykohet më 6 muaj burg duke ia shndërruar në gjobë, kurse i akuzuari G.M për dhënien e ryshfetit në shumë prej00 euro dënohet me 9 muaj burg efektiv. Sipas mbrojtjes vendimi me i drejtë i gjykatës për të akuzuarin G.M, kishte për të qenë që i njëjti për 2 veprat penale për të cilat është shpallur fajtor të gjykohet me dënim burgu unik prej 9 muajsh, për kohën që ka qenë në paraburgim dhe arrest shtëpiak, e jo edhe më gjobë për veprën penale mashtrimi më subvencione.

Lidhur me mjetet e sekuestruara thekson se gjykata të hollat e tërhequra nga banka nga i akuzuari G.M, në shumë prej00 euro, për kompensimin e Ministrisë së Bujqësisë, të sekuestruara sipas urdhëresës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPPS.nr.47/21 të datës 02.02.2022, është dashur të vendos që këto mjete të bartën në xhirollogarinë e Ministrisë së Bujqësisë, në emër të kompensimit të dëmit nga i akuzuari G.M, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit D.D, av.Sali Mekaj, thekson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, nuk i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese, të cilat do të ishin me ndikim për shqiptimin e një dënimi me të butë për të akuzuarin. Së pari, gjykata nuk e ka vlerësuar në masë të mjaftueshme shkallën e ulët të përgjegjësisë penale, pse i akuzuari ka qenë i detyruar që të veproj e të sillet sipas udhëzimeve të personave zyrtar që

në rastin konkret e kanë përfaqësuar Ministrinë e Bujqësisë, e të cilët kanë vendosur për dhënien e subvencioneve për fermerët siç ka qenë edhe i akuzuari D.D.

Ka shtuar se nga përmbajtja e mbrojtjes së të akuzuarit D.D, por edhe nga mbrojtja e të akuzuarit B.M, i cili duke qenë në cilësinë e personit zyrtar, i autorizuar për vlerësimin e kushteve për dhënien e subvencioneve, i ka kërkuar ryshfet të akuzuarit D.D, për veti dhe për personat e tjerë zyrtar duke përfshirë edhe eprorin e tij të akuzuarin L.S, duke theksuar së nëse nuk u jepet shuma e kërkuar ata do ta fusin biznesin e tij në listën e ndalesave, dhe për tri vitet në vijim nuk do të këtë të drejtë të marrë subvencione.

Me këto kushtëzime ata e kanë detyruar të akuzuarin D.D, që të pajtohet jo vetëm me dhënien e një pjese të shumës që i është kërkuar në emrin e ryshfetit, por është detyruar që të veproj sipas udhëzimeve të tyre për rritjen e numrit të zogjëve që i kishte në fermë, me qëllim të rritjes së kuotes së subvencionimit, në mënyrë që ata ta realizojnë në tërësi shumën e kërkuar.

Tutje ka shtuar se i akuzuari i ka plotësuar në tërësi kriteret për subvencionim, sepse ai i ka pasur000 zogj në fermën e tij, por duke qenë se ishte vitit 2020, kur ishte pandemia dhe ishte vështirësuar furnizimi me ushqime dhe për shkak të mungesës së mjeteve për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e ushqimit, ka qenë i detyruar që ti pranoj kushtet e caktuara nga personat zyrtar, krejtësisht kundër vullnetit të tij, prandaj kjo paraqet shkallë të ulët të përgjegjësisë penale të të akuzuarit, e që nuk është vlerësuar në masë të duhur nga ana e gjykatës, se dyti, i akuzuari e ka kompensuar dëmin që i është shkaktuar të dëmtuarës, me kompensimin e shumës së marrë në emër të subvencioneve, nga rritja e numrit të zogjve dhe kjo paraqet rrethanë tjetër lehtësuese që nuk është vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Gjoha e shqiptuar në total prej000.00 nuk është në përputhje me mundësit materiale dhe financiare të të akuzuarit, kështu që pagesa e kësaj gjobe ta vendoste në pozitë të vështirë të akuzuarin dhe biznesin e ti, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Në ankese mbrojtësi i të akuzuarit H.M, av.Arbër Jashari, thekson se dënimi i shqiptuar, ndaj të akuzuarit është i lartë dhe se qëllimi i dënimit i përcaktuar me nenin 38 të KPRK-së, do të mund të arrihej edhe me një sanksion më të butë. Sipas mbrojtjes gjykata, nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese dhe ato posaçërisht lehtësuese sikur që janë: se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, është penduar për veprimet e tij, ka kërkuar edhe falje, faktin që ai ka qenë i sjellshëm dhe ka bashkëpunuar me organet ligj-zbatuese gjatë gjithë procedurës penale dhe se dëshmia e tij ka pasur impakt të madh në zbardhjen e gjithë rastit penal, sjellja korrekte pas

kryerjes se veprës penale. Pastaj gjykata nuk i ka çmuar sa duhet edhe rrethanat personale të akuzuarit, faktin se është bujk, familjar, jeton në saje të ardhurave që fiton nga bujqësia dhe blegtoria, më parë nuk ka qenë subjekt i ndonjë vepre penale dhe po ashtu askund nuk e ka marr për bazë faktin se paratë të cilat i akuzuari i'a ka dhënë në formë ryshfeti të akuzuarit B.M, nuk e ka bërë nga dëshira, por sepse atij i është kërkuar me lajthim dhe mashtrim nga ky i fundit, në një mënyrë ka qenë i detyruar. Andaj nisur nga të gjitha këto, kërkon nga Gjkata e Apelit që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të rrethanave lehtësuese, ta aprovoi ankesën dhe të akuzuari ti shqiptojë dënim me të butë.

Vlerësimi i Gjykatës se Apelit

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e mbrojtëseve të akuzuarve për një dënim me të butë nuk janë të bazuara.

Gjkata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese për të gjithë të akuzuari gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga të akuzuarit G.M, A.M, D.D dhe H.M për veprat penale për të cilat akuzohen, pendimi për kryerjen e veprës penale, bashkëpunimi dhe sjellja e tyre korrekte me gjykatën, por gjithashtu edhe me organet e ndjekjes penale dhe atë që në fazat e hershme hetimore, ku një fakt të tillë e dëshmon edhe vet përfaqësuesi i organit të akuzës, si dhe është hera e parë që bien ndesh me ligjin, në bazë të të dhënave nuk rezulton se më herët kanë pasur të kaluar kriminale apo kanë kryer ndonjë vepër penale, gjithashtu i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen do të jenë më të kujdesshme, nuk do bien ndesh me ligjin dhe nuk do të përsërisin ndonjë vepër penale. Duke i vlerësuar rrethanat e lartcekura të akuzuarve iu ka shqiptuar sanksionin penal dhe detyrimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë penalo juridike të tyre dhe se me këtë sanksion dhe detyrim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara në ankesat e mbrojtëseve se nuk janë vlerësuar rrethanat lehtësuese të cituara, janë pretendime të pa bazuara pasi këto rrethana kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykata

e shkallës së parë, si të tilla nuk janë të asaj natyre që e justifikojnë një dënim më të butë, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit edhe të Kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve nga ana e Gjykatës së shkallës së parë janë proporcionale dhe në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë së veprës së kryer penale, shkallën e përgjegjësisë penale së të akuzuarit, mënyrës dhe rrethanave të kryerjes dhe se me këto dënime mund të parandalohen të akuzuarit nga kryerja e veprave të tjera penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Çështja e kompensimit të dëmit

Lidhur me kërkesën e mbrojtësit G.M, av.Reshat Millaku, që të hollat e tërhequra nga banka nga i akuzuari G.M, në shumë prej00 euro, për kompensimin e Ministrisë së Bujqësisë, të sekuestruara sipas urdhërësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPPS.nr.47/21 të datës 02.02.2022, është dashur të vendos që këto mjete të bartën në xhirollogarinë e Ministrisë së Bujqësisë, në emër të kompensimit të dëmit nga i akuzuari G.M.

Kolegji penal duke shqyrtuar kërkesën e mbrojtësit të akuzuari G.M, av.Reshat Millaku, pas vlerësimit të fakteve të çështjes ka ardhur në përfundim se kërkesa e mbrojtësit është e bazuar.

Në praktikën gjyqësore çështja e institutit të konfiskimit të detyrueshëm të përfitimeve pasurore të fituara me vepër penale nga njëra anë, dhe e pretendimeve pasurore nga ana tjetër, mund të konceptohen si domosdoshmërisht të lidhura me njëra-tjetrën, pasi në shumë raste dëmi që rezulton nga kryerja e veprës penale është objekt i kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit, njëkohësisht paraqet edhe dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale nga i akuzuari.

Në raportin e kundërt në mes këtyre dy kërkesave, kërkesa pasurore e të dëmtuarit mbizotron, kështu që konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale është i mundur vetëm në masën që përfitimi i tillë tejkalon vlerën e kërkesës pasurore të dhënë.

Për rrjedhojë, në çështjen që është objekt shqyrtimi kompensimi i dëmit financiar i shkaktuar Ministrisë së Bujqësisë, duhet të bëhet nga mjetet e konfiskuara sipas urdhëresës së gjykatës së shkallës së parë, PPPS.nr.47/21 të dt.02.02.2022 në lartësi prej00.00 €, të përcaktuara si në aktgjykimin e ankimuar.

Nga arsyet e sipërcekura e në bazë të nenit 401 dhe 403 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI SPECIAL

APS.nr.44/2023

Datë: 30.10.2023

Bashkëpunëtorja Profesionale,

Anëtarët e kolegjit,

Kryetare e kolegjit,

Syzana Goxhuli

Bashkim Hyseni

Afërdita Bytyçi

Vaton Durguti